

RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10465, DATË
29.09.2011 “PËR SHËRBIMIN VETERINAR NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Qëllimi i këtij projektligji është që nëpërmjet ndryshimeve në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar të bëhet e mundur zbatimi i reformës së shërbimit veterinar dhe plotësimi i bazës ligjore në kuadër të unifikimit të tij duke mundësuar kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHRAU pasi me miratimin e ligjit nr. 139/2015 ”Për vetëqeverisjen vendore”, njësitë e qeverisjes vendore nuk i kanë më këto struktura.

Gjithashtu gjatë zbatimit të detyrave të përdishme, shërbimi veterinar ka hasur vakume ligjore të ndryshme të pa pasqyruara në ligjin nr. 10465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nëpërmjet këtyre ndryshimeve synohet të përmirësohet kuadri ligjor për të mbështetur punën e shërbimit veterinar në ngritjen e standardeve me lidhje me shëndetin e kafshëve dhe regjistrimin e Produkteve Mjekësore Veterinare.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA
POLITIKE**

Ky projektakt del si nevojë në plotësimin e kuadrit ligjor në lidhje me kalimin e kompetencave dhe funksioneve të shërbimit veterinar të pushtetit lokal në strukturën e shërbimit veterinar në MBZHRAU dhe vakume ligjore të ndryshme duke synuar përmirësime në kuadrin ligjor në mbështetje të punës së shërbimit veterinar në arritjen e objektivave dhe standarteve të BE-së të përcaktuara në politikat dhe strategjitë e Qeverisë në tërësi dhe MBZHRAU në veçanti.

Ky projektvendim nuk është parashikuar në Programin Analitik të Akteve që do të paraqiten për shqyrtim në vitin 2016, miratuar me vendimin nr. 136, datë 24.02.2016, por miratimi i tij është shumë i rëndësishëm.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet ndryshimeve që sjell ky projektligj do të mundësohet që:

- Të unifikohet shërbimi veterinar aktualisht i fragmentuar në atë të shërbimit veterinar në strukturat e MBZHRAU dhe atë të në njësitë e qeverisjes vendore.
- Fusha e veprimtarisë së veterinerit zyrtar do të përfshijë edhe kontrollin shëndetësor të kafshës para dhe pas therjes, tregjet e kafshëve të gjalla, kullota dhe njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe zbukurimit.
- Të përmirësohet procedura e regjistrimit e Produkteve Mjekësore Veterinare dhe lejimit të hyrjes dhe tregëtimit të tyre vetëm pasi ai tregëtohet në të paktën në një nga vendet e BE-së.
- Në fermat të zbatohen masat e biosigurinë me qëllim reduktimin e rrezikut të hyrjes, zhvillimit ose përhapjes të sëmundjeve tek kafshët në fermë dhe/ose objekt, zonat ose çdo ambienti tjetër dhe mjetet e transportit”.
- Të përmirësohet ligjit aktual duke e përafruar atë me standardet e vendosura në Ligjin e Shëndetit të Kafshëve të BE-së.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk ka përafrim me legjislacionin e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në këtë projektligj ka 31 nene të cilat kanë përmbajtje si më poshtë:

- Në nenin 1 synohet që të plotësohet që ligji ka për qëllim edhe të përcaktojë rregullat për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve në lidhje me klasifikimin e tyre, vendosjen e masave urgjente që duhen marrë në rast të shpërthimit, miratimin dhe regjistrimin e objekteve dhe mjeteve transportuese, garantimin e lëvizjes dhe gjurmueshmërisë për hyrje daljen e kafshëve, produkteve embrionale dhe produkteve me origjinë shtazore, jo për konsum human në Shqipëri.
- Në nenin 2 synohet që të plotësohet objekti i ligjit për kafshët, produktet embrionale, produktet me origjinë shtazore jo për konsum human, subjektet, mjetet e transportit, pajisjet si dhe, si dhe çdo material i cili ndikon ose është i prirur të ndikojë në përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme të kafshëve.
- Në nenin 3 synohet që të plotësohen përkufizimet edhe për termat Biosiguri, hetim epidemiologjik, sistemi i informacionit të epidemiologjisë veterinarë, stabiliment dhe survejancë.
- Në nenin 4 synohet që të plotësohet baza ligjore dhe llojet e kafshëve të prodhimit që do të identifikohen.
- Në nenin 5 synohet që të plotësohet baza ligjore për identifikimin e të gjitha kafshëve të shoqërimit.
- Në nenin 6 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me monitorimin e sëmundjeve të listuara dhe plotësimi i kësaj liste me sëmundje e reja që shfaqen.
- Në nenin 7 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me masat e përgjithshme profilaktike.
- Në nenin 8 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me veprimet e Veterineri zyrtar në rastin e dyshimit të një sëmundjeje infektive.
- Në nenin 9 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me marrjen e masave paraprake profilaktike në rastin e dyshimit të një sëmundjeje infektive.
- Në nenin 10 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me miraton rregulloret përkatëse për masat që duhet të zbatohen në fermën e vendosur nën mbikëqyrje zyrtare, sipas pikës 2 të këtij neni, për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve sipas situatës”.
- Në nenin 11 synohet që të bëhen ndryshimet për të plotësuar bazën ligjore në lidhje me masat e autoritetit kompetent për kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve.
- Në nenin 12 synohet që të bëhen ndryshimet për të plotësuar bazën ligjore në lidhje me detyrat për pronarët ose kujdestarët e kafshëve të prodhimit.

- Në nenin 13 synohet që të bëhen ndryshimet për të plotësuar bazën e nevojshme ligjore në lidhje me funksionet e njësive të qeverisjes vendore.
- Në nenin 14 synohet që të bëhen ndryshimet për të plotësuar bazën e nevojshme ligjore në lidhje me ekspozitat dhe panairët.
- Në nenin 15 synohet që të bëhen ndryshimet për të plotësuar bazën e nevojshme ligjore në lidhje me urdhërimin nga Veterineri zyrtar për eliminimin e detyrueshëm në vend për kafshët me dëmtime të rënda.
- Në nenin 16 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me rregullat për lëvizjen e kafshëve të egra tokësore.
- Në nenin 17 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje rregjistrimin e PMV-ve nga Komisioni Shtetëror.
- Në nenin 18 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me rregullat për përjashtimet në përdorimin e PMV-ve në kafshë.
- Në nenin 19 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me afatet për miratimin nga Komisioni Shtetëror i PMV-ve.
- Në nenin 20 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me veprimtaritë e deleguara të klinikës veterinare.
- Në nenin 21 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me veprimtaritë e deleguara të klinikës veterinare.
- Në nenin 22 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me laboratorët veterinarë shtetërorë.
- Në nenin 23 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me masat në lidhje me biosigurinë dhe të izolimit biologjik agjenteve patogjenë, vaksinave dhe produkteve të tjera biologjike.
- Në nenin 24 synohet që të plotësohet të shfuqizohet baza ligjore në lidhje me veprimtaritë që mbulojnë Strukturat veterinare në njësitë e qeverisjes vendore.
- Në nenin 25 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me bashkëpunimin dhe marrëveshjet me Policinë e Shtetit.
- Në nenin 26 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me fushën e veprimtarisë së veterinerit zyrtar.
- Në nenin 27 synohet që të plotësohet baza ligjore në lidhje me funksionet e veterinerit zyrtar për kontrollet në thertore, tregjet e kafshëve të gjalla dhe kullota, njësitë e shitjes së kafshëve të shoqërimit dhe mbledhjen, grumbullimin dhe groposjen e kadavrave të kafshëve.

- Në nenin 28 synohet që të bëhen disa përmirësime përsa i përket kundërvajtjeve administrative, kur veprohet në kundërshtim në lidhje me masat e përgjithshme profilaktike dhe prodhimin e PMV-ve në vend.
- Në nenin 29 synohet që të bëhen disa përmirësime përsa i përket kuadrit ligjor të licencimit, pezullimit dhe revokimit të veprimtarive të cilat i përkasin kategorive e nënkategorive respektive të fushës II të shtojcës së ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Në nenin 30 përcaktohet që ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Drejtoria Veterinare dhe Drejtoria Juridike Drejtorinë në MBZHRAU, si ministria përgjegjëse për shërbimin veterinar, ka përgatitur këtë projektligj Drejtoria Veterinare pas konsultimit me Drejtorinë Juridike në MBZHRAU, si ministria përgjegjëse për shërbimin veterinar, ka përgatitur këtë projektligj për tu publikuar në faqen elektronike të MBZHRAU në adresën www.bujqesia.gov.al/ dhe njoftimit me shkresë të të gjitha bashkive të vendit, Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar dhe depove farmaceutike veterinare si palë të mundshme të interesuara për efektet që do të sjellin ndryshimet e parashikuara në këtë projektakt.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE